



Si funksionojnë shkollat në kantonin Basel-Stadt?

Basel-Stadt (Bazeli-Qytet) i ka riorganizuar shkollat në mënyrë graduale. Në vijim do ta prezentojmë sistemin e ri shkollor.

Arsimi i detyrueshëm zgjat për njëmbëdhjetë vjet (duke përfshirë edhe kopshtin). Fëmijët të cilët flasin pak ose nuk e njohin fare gjuhën gjermane, janë të obliguar, që të marrin pjesë të paktën dy gjysmë-dite në javë, që mërmes lojërave t'u ipet mundësia të mësojnë gjermanisht. Ky obligim për **zhvillimin e gjuhës gjermane** realizohet gjatë vitit para se të hyjnë në kopshtin e fëmijëve.

Periudha e arsimit të detyruar shkollor fillon me **Kindergarten** (kopshtin e fëmijëve). Në kopshtin e fëmijëve shkojnë fëmijët nga mosha 5 vjeçe. Deri në vitin 2016 data e fillimit të regjistrimit në shkollë do të shtyhet në etapa deri më 31 korrik (krahaso pasqyrën e datave në faqen www.volksschulen.bs.ch → Schulsystem → Kindergarten). Kopshti i fëmijëve zgjat 2 vjet dhe ndodhet në lagjen ku banon fëmija. Numri maksimal i fëmijëve në një klasë është 20. Viti shkollor fillon në gusht. Formularët e regjistrimit në kopshtin e fëmijëve ju dërgohen prindërve me postë gjatë muajit dhjetor të vitit paraprak.

Pastaj vijon **Primarschule** (shkolla fillore), e cila zgjat gjashtë vjet dhe ndodhet në lagjen ku banon fëmija. Mësimi i gjuhës frenge fillon në klasën e tretë, ndërsa ai i gjuhës angleze në klasën e pestë. Numri maksimal i nxënësve në një klasë është 25.

Pas shkollës fillore, fëmijët ndjekin **Sekundarschule** (shkollën dytësore). Ajo zgjat tre vjet. Në varësi të rezultateve shkollore, fëmijët klasifikohen në nivele të ndryshme (shkallë të rezultateve shkollore). Ata ndjekin ose shkallën-A (kërkesa të përgjithshme), shkallën-E (kërkesa të zgjeruara) ose shkallën-P (kërkesa të larta). Shkollat dytësore (Sekundarschulen) do të jenë në dhjetë vende, të shpërndara në tërë Qytetin e Bazelit. Nxënëset dhe nxënësit mund ta ndërrojnë shkallën e tyre, po qese rezultatet e tyre dukshëm kanë ndryshuar. Në shkallën-A numri maksimal i nxënësve në një klasë është 16 të rinjë, në shkallën-E 23 të rinjë dhe në shkallën-P 25 të rinjë. Në fund të vitit të 11-të të shkollës do të pajisen të gjithë nxënësit me një dëftesë të shkollës popullore (letërnjoftim rezultatesh).

Informacione më të hollësishme rreth shkollave të qytetit të Bazelit jepen në **takimet informative për prindërit**, ku shkollat ju ftojnë çdo vit. Këto takime informative janë me interes për prindërit e fëmijëve që gjatë verës do të shkojnë në kopshtin e fëmijëve ose në një shkollë të re. Në shumë prej këtyre takimeve ipen informata në gjuhën shqipe.

Informata të mëtejshme rreth shkollave të qytetit të Bazelit mund të merrni

- në faqen elektronike të Departamentit të Arsimit www.ed.bs.ch
- tek sekretariati i shkollave fillore në Kohlenberg 27, Postfach, 4001 Basel, 061 267 54 60, volksschulen@bs.ch
- ose tek shkollat individuale.

info

Duke filluar nga kopshti i fëmijëve bëhet vlerësimi i punës së nxënësve përmes **raportit të mësimi** dhe mbahen **takime me prindërit**. Pastaj nga klasa e parë e shkollës fillore nxënësit marrin edhe **dëftesa**, ndërsa nga klasa e pestë vlerësimi bëhet me **nota**. Çdo klasë e shkollave popullore (**Volksschule**) (kopshtet e fëmijëve, shkollat fillore, shkollat dytësore) delgohen nga dy prindër dhe çdo shkollë ka një këshill shkollor me dy përfaqësues të prindërve.

Jashtë mësimi kopshtet e fëmijëve, shkollat fillore dhe shkollat dytësore ofrojnë edhe **Tagesstrukturen** (struktura ditore) si më poshtë vijon. Kundrejt një pagese të caktuar nga ana e prindërve, fëmijët gëzojnë përkujdesje, ushqehen dhe ndihmohen në **Schulen mit Tagesstrukturen** (shkollë me strukturë ditore), **Mittagstische** (ushqimi i drekës), **Tagesheime** dhe **Tagesfamilien** (kopshte ditore dhe familje për përkujdesje ditore). Gjatë periudhës së pushimeve ka **Tagesferien** (pushime ditore). Në të gjitha shkollat zbatohen **Blockzeiten** (orare të unifikuar). Fëmijët shkojnë në shkollë nga e hëna deri





Si funksionojnë shkollat në kantonin Basel-Stadt?

Informationen in den Sprachen
Deutsch, Français, Italiano, English,
Español, Shqip, Srpski hrvatski, Tamil,
Türkçe: www.ed.bs.ch → welcome

të premtën prej orës 8 deri 12, si edhe një pasdite (në kopshtet e fëmijëve) e përkatësisht disa pasdite (duke filluar nga shkolla fillore).

Periudha njëmbëdhjetëvjeçare e arsimit të detyruar shkollor mbaron mbas shkollës dytësore. Në vijim, të rinjve në përputhje me rezultatet e arritura u ofrohen këto mundësi:

- Kryerja e një **Berufslehre** (shkollë profesionale). Matura profesionale e zhvilluar gjatë ose pas shkollës profesionale iu hap rrugën e studimeve pranë një instituti të lartë profesional,
- Vazhdimi i shkollës dhe ndjekja e një shkollë profesionale me orar të plotë ose një **Fachmaturitätsschule** (shkollë profesionale me maturë),

- Ndjekja e Gymnasium (gjimnazit). Gjimnazi vazhdon katër vjet dhe përfundon me marrjen e maturës. Pas gjimnazit, të rinjtë mund të studiojnë në një universitet.
- Ju e vizitoni një ofertë urë (Brückenangebot), për deri sa ju ende nuk e keni gjetur një lidhëshmëri adekuate.

Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, po të jetë e mundur ndjekin mësimet në klasa të rregullta dhe, veç kësaj, gëzojnë përkrahjen e pedagogëve shërues. Ekzistojnë gjithashtu oferta të veçanta në shkolla të posaçme shtetërore dhe private.

Die Schullaufbahnen auf einen Blick

